

XPERT është kontraktor i rretit të dyqaneve GLOBE për shërbimet e servisit brenda dhe jashtë periudhës së garancisë. Garancia është e vlefshme vetëm me paraqitjen e këtij dokumenti së bashku me faturën e blerjes.

Nëse keni sugjerime, vërejtje, apo gjendeni në veshitësi nga shërbimi i ofruar nga **XPERT**, ju lutem mos hezitoni ti drejtoheni GLOBE në departamentin e Kujdesit ndaj Klientit në kontaktet:

 **04 48 06 061**  **info@globe.al**

I/E NDERUAR KLIENT

LEXONI ME VËMENDJE DHE REFEROHUNI NË MANUALIN E PËRDORIMIT PËR TË PËRFITUAR REZULTATE MAKSIMALE TË PAJISJES, PËRDORIM TË SIGURTË DHE INFORMACIONIN E NEVOJSHËM PËR MIRËMBAJTJEN E SAJ.

A. ME KËTË GARANCI JU PËRFITONI:

1. Funksionimin optimal dhe brenda parametrave të shfaqura në tabelën teknike të pajisjes bazuar në udhëzimet e manualit të përdorimit.
 2. Riparimin pa pagesë të të gjitha defekteve që vijnë nga prodhuesi.
 3. Shërbim në adresë dhe transport pa pagesë për realizimin e shërbimeve të servisit për çdo pajisje që paraqet veshitësi transportimi dhe peshë mbi 20kg. Pajisjet e vogla mund të transportohen lehtësisht nga klienti në pikat e pranimit të **XPERT**.
 4. Konstatimin pa pagesë të problemit dhe informimin tuaj brenda 2 ditë pune nga momenti i ardhjes së pajisjes në servis.
 5. Riparimin pa pagesë brenda 1-3 ditë pune nga momenti i konstatimit të problemit.
 6. Riparimin pa pagesë brenda 30 ditë pune të çdo pajisje që nevojitet t'i porositet pjesë nga prodhuesi për t'u sjellë në përputhje me funksionimin sipas parametrave të tabelës teknike.
 7. Ofrimin pa pagesë të një pajisje zëvendësuese në përdorim në rastet kur afati i riparimit zgjat më shumë se 3 ditë pune.
 8. Garanci 1 javore për aksesoret shoqërues të pajisjes (bateri, karikues, kabëll, gominë, etj) apo pjesëve të konsumit si (baza e karikimit, filtra, llambë, telekomandë etj).
 9. Zëvendësimin e pajisjes me defekt fabrike të paraqitur Brenda 72 orëve nga data e blerjes dhe të konstatuar nga teknikët e autorizuar të **XPERT**. Kujdes, pajisja duhet të jetë e pa dëmtuar fizikisht.
- Ne gjithashtu sugjerojmë për pajisjet që u lindin problematika jashtë periudhës së garancisë, ti drejtoheni servisit të autorizuar **XPERT** për të përfutur shërbim profesional nga staf i kualifikuar. Në këtë rast shërbimi do të tarifohet dhe dakordësohet ndërmjet jush.

KUJDES!!!

B. GARANCIA NUK ËSHTË E VLEFISHME NË RASTET KUR:

1. Pajisja nuk shoqërohet me këtë Fletë Garancie dhe faturën e blerjes që lëshohet nga subjekti i autorizuar.
2. Pajisja dëmtohet fizikisht me ose pa dashje ose pajisjes i është dëmtuar pulla e garancisë (etiketa në trup të pajisjes).
3. Pajisja ka NDËRHURJE nga persona të pa autorizuar nga **XPERT**.
4. Pajisja është keqpërdorur, nuk është përdorur sipas kushteve dhe tabelës teknike të vendosura dhe afishuara nga prodhuesi.
5. Pajisja nuk është mirëmbajtur dhe nuk është përdorur në përputhje me udhëzimet që gjenden në manualin e përdorimit.
6. Pajisja është dëmtuar nga MBITENSIONI, NËNTENSIONI, LUHATJET DHE GODITJET E TENSIONIT.
7. Pajisja është dëmtuar nga fenomene dhe shkaqe natyrore.
8. Pajisja nuk është montuar sipas parametrave teknike dhe konstatohet nga teknikët e **XPERT**.
9. PAJISJA NUK PËRDORET PËR PËRDORIM SHTËPIAK.
10. Dëmtohet nga materiale likuide (lagështirë, lëngje të ndryshme) apo inerte (rërë, pluhur, insekte, etj).
11. Problemet që i shkaktohen pajisjes (elektronike) që vijnë si pasojë e aplikacioneve të pa licënuara të tipeve malware/viruse ose si pasojë e modifikimit dhe ndërhyrjes në sistemin operativ dhe komponentët e tij.
12. Në pajisjet si celularë/tablet janë kryer modifikime të Root dhe Jailbreak.
13. Funksionimi i pajisjes jo në përputhje me parametrat teknikë vjen si pasojë e funksionimit jo siç duhet ose konsumimit të aksesoreve shoqërues (bateri, karikues, kabëll, gominë, etj) apo pjesëve të konsumit si (baza e karikimit, filtra, llambë, telekomandë etj).
14. Garancia nuk është e vlefshme për sende të brishta si qelqi, pjesët delikate ose sende të konsumueshme si llamba, gomina, filtra, karikues, bateri, etj



Për çdo pajisje celular/tablet që pranohet në XPERT është e detyrueshme nga prodhuesi të riprogramohet me versionin e fundit të sistemit operativ dhe të rikthehet në gjendje fillestare të fabrikës pavarësisht nga natyra e problemit për të cilin është paraqitur.

Është përgjegjësi e konsumatorit që të bëjë kopje rezervë të të gjitha të dhënave, softuerit dhe programeve dhe t'i fshijë të gjitha të dhënat ekzistuese nga pajisja e tij para marrjes së shërbimeve.